




Pranuar / Dorezuar Priljena / Prodato Received / Delivered	15.11.2021	viti god year	1
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojç e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHQ	5454/2021		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.837/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.837/2021 të datës 29.09.2021 të parashtruar nga _____ nga Prishtina, kundër Vendimit të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës me numër protokolli 01041 të datës 16.09.2021 për transferim të përkohshëm, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.837/2021, e datës 29.09.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 01041 i datës 16.09.2021 për transferim të përkohshëm, i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

III. Obligohet Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimit, ta kthejë ankuesin në vendin e punës sipas Kontratës së Punës të datës 30.06.2018 më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

IV Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 29.10.2021 përmes organit të punësimit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues me numër protokolli 01041 i datës 16.09.2021 për transferim të përkohshëm

thelbësore të së drejtës materiale, duke shtuar me tej se për transferimin e tij nuk ka pasur ndonjë arsye ashtu siç përcaktohet me nenin 225 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2021 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 me te cilin është përcaktuar se: *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë, rrjedhë se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht se të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil si dhe ligjeve të veçanta nga fushë veprimtaria e Shërbimit Korrektues.*

Lidhur me trajtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 52 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se " *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve;2. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale; 2.2. në një agjenci ekzekutive të institucionit ku është emëruar; 2.3. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se " 1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit.*

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, Kolegji ka analizuar edhe dispozita e Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale si ligj i veçantë përkatësisht nenin 225 paragrafi 1 që përcakton se: "1. *Personi i punësuar në Institucionin korrektues nga neni 221 paragrafi 1. i këtij ligji, për shkak të nevojave të punës, apo për shkak të rritjes së vëllimit të punëve, mundet të transferohet përkohësisht pa pëlqimin e tij në Institucionin tjetër korrektues më së gjati gjatë (6) muaj gjatë dy (2) viteve, ndërsa me pajtimin e tij më së gjati dymbëdhjetë (12) muaj*".

Në mbështetje të dispozitave ligjore si me lartë dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka vlerësuar se vendimi i goditur më ankesë nuk përmban sqarimin e nevojshëm dhe mjaftueshëm lidhur me nevojën e Institucionit për transferimi e ankuesit nga pozita e punës së Zyrtarit Korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë në pozitën e Zyrtarit Korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Përkritazi me vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të atakuar me ankesë, Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e nenit 52 paragrafi 3 nënpragrafi 3.2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se " *Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste:... 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 100 km nga vendbanimi i nëpunësit civil*" dhe rrjedhimisht ka konstatuar se në qoftë se vendi në të cilit transferohet përkohësisht nëpunësi civil është më shumë se 100 km nga vendbanimi i tij/saj, i njëjti posedon të drejtën e refuzimit të transferimit të përkohshëm.

Duke marr parasysh se marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil është marrëdhënie juridike e së drejtës administrative, Kolegji vlerëson se Vendimi me numër protokolloi 01041 i datës 16.09.2021 për transferim të përkohshëm të ankuesit, është në kundërshtim me nenin 47 paragrafin 1 nën



paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht vendimi nuk përmban pjesën arsyetuese (arsyetimin) dhe pjesën përmbyllëse gjegjësisht këshillën ligjore lidhur me ushtrimin e mjeteve juridike, si elemente të detyrueshme të aktit administrativ, e mbi këtë konstatim rezulton se një akt administrativ i nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ konsiderohet akt administrativ i paligjshëm ashtu siç është përcaktuar me neni 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.837/2021.

Çlirim Zeka

Procesmbajtës


Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së